



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality of Rahovec / OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



Rahovec / RAHOVEC

Drejtoria për Administratë të përgjithshme

Odaljenje za Opštë Upravu

-III- Nr. i prot. 692 Më 04.07.2018
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

DËMET NË BUJQËSI

Raport i vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga breshëri dhe vërshimet

Rahovec, qershor 2018



Përbajtja

HYRJE.....	2
KOMISIONI PËR VLERËSIMIN E DËMEVE.....	2
SEKTORËT E DËMTUAR.....	5
Sektori i vreshtarisë.....	5
Sektori i lavërtarisë	6
Sektori i Perimekulturës.....	7
Sektori i pemëtarisë	8
PËRFUNDIM.....	9

HYRJE

Si pasojë e të reshurave të mëdha të breshërit dhe shiut, ky raport do të paraqes një përshkrim të dëmeve në kulturat bujqësore, në bazë të informacioneve të reportuar nga banorët e Komunës së Rahovecit si dhe nga analiza e zyrtarëve që kanë dalë në terren.

Raporti përmban të dhëna të sakta nga vizita në terren, harta si dhe fotografi që e dëshmojnë dëmin e shkaktuar në kultura të ndryshme bujqësore që kultivohen në Komunën e Rahovecit.

Të gjitha këto të dhëna janë të nxjerra nga listat e përpiluara nga anëtarët e komisionit në terren gjatë vizitës në secilën parcelë që është prekur nga breshëri dhe vërshimet.

KOMISIONI PËR VLERËSIMIN E DËMEVE

Në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës, nr. 01/308/18, i datës 18.06.2018, z. Smajl Latifi, është formuar komisioni vlerësues për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në bujqësi nga breshëri dhe reshjet e rrëmbyeshëm të shiut gjatë ditëve 14, 15, 16 qershori dhe në vazhdim në komunën e Rahovecit, në përbërjen:

- | | |
|---------------------------|-----------------|
| 1. Nysret Shala, | kryesues |
| 2. Jeton Kryeziu, | anëtar |
| 3. Ilvi Durguti, | anëtar |
| 4. Selami Mashuku, | anëtar |
| 5. Arben Sokoli, | anëtar |

Me kërkesë të kryetarit të Komunës dhe pëlqimit nga Drejtori i Departamentit të Vreshtarisë dhe Verëtarisë (DVV), komisionit i është bashkangjitur dhe Tasim Bajrami, zyrtar për vreshtari nga departamenti i Vreshtarisë dhe Verëtarisë në Rahovec.

Për vlerësim sa më real të dëmeve të shkaktuara, ky komision është ndarë në tri grupe për të përfshirë të gjitha zonat e prekura dhe të gjitha kulturat bujqësore në komunën e Rahovecit, në një afat sa më të shkurtër.

Komisionet vlerësuese, që nga data 18.06.2018 kanë dalë në terren, duke mbledhur informacione dhe mbajtur shënimë se




në cilat zona ka pasur dëme nga breshëri dhe përbmytje nga reshjet e rrëmbyeshëm të shiut.

Breshëri ka filluar në orët e pasdites së datës 14.06.2018 dhe ka zgjatur mbi 30 minuta në disa zona të komunës së Rahovecit, të cilat më pastaj janë shoqëruar me reshje të rrëmbyeshme duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në të gjitha kulturat bujqësore të cilat janë përfshirë nga kjo fatkeqësi natyrore.

Sipas vlerësimit të komisionit, sipërfaqet e tokave bujqësore të atakuara nga breshëri janë mbi 2,280 ha dhe ka përfshirë këto zona: Sapniq, Potoqan i Ulët, Bellacërkë, Xërxe, Gexhë, një pjesë e Radostës, Bërnjak, Celinë, Nagac, Hoçë e Vogël dhe Brestoc.

Dëmet më të mëdha nga breshëri janë shkaktuar në zonat kadastrale si: Sopniqi, Potoqan i Ulët dhe Gexhë, atë të Bellacerkës dhe Bërnjakës, duke u shpërndarë përrreth me një shkallë më të ulët, përqindja e demit të shkaktuar në këto zona ka qenë deri në 100% në disa kultura bujqësore.

Hartë e dëmtimit të vreshtave nga bresheri në Komunën e Rahovecit



Përveç dëmeve nga breshëri, reshjet e shiut të cilat kanë vazhduar për disa ditë rresht, kanë ndikuar që përrrenjtë e fshatrave të dalin nga shtrati i tyre dhe si rezultat i kësaj janë përmbytur shumë toka bujqësore. Për këtë, Drejtoria e Bujqësisë ka vlerësuar gjendjen në terren ku edhe janë bërë ndërhyrjet e nevojshme për të tejkular situatën emergjente. Fotoja e bashkangjitur paraqet njërin nga përrenjtë në Komunë të Rahovecit e cili në pamundësi për të përballuar intenzitetin e lartë të reshjeve, ka bërë që rrjedha e ujit të dalë nga shtrati dhe kështu të shkaktoj dëme të konsiderueshme.



Dëmet më të mëdha nga vërshimet kanë ndodhur në zonën kadastrake Krushë e Madhe, ku përroi i cili ndan fshatrat Krushë e Madhe dhe Celinë ka dal nga shtrati i vet dhe ka përmbytur mbi 200 ha të tokave bujqësore, e të cilat në këtë kohë ishin në kohën më të mirë të vegjetacionit. Përveç dëmeve në tokat bujqësore dëme janë shkaktuar edhe në infrastrukturë, me theks të veçantë te Serrat e ndërtuara të banorëve të Krushës së Madhe dhe Celinës.



Harta nr. 2, Hapësirë e cila është vërvshuar nga dalja e përroit nga shtrati në mes të fshatrave Krushë e Madhe dhe Celinë.

SEKTORËT E DËMTUAR

Kushtet klimatike të mesit të muajit qershori 2018, ishin të atilla që shkaktuan dëme pothuajse në të gjithë sektorët e bujqësisë në Komunën e Rahovecit.

Nga breshëri dhe vërshimet janë dëmtuar shumë sektorë të cilët do të grupohen në 4 grupe:

1. Sektori i vreshtarisë,
2. Sektori i lavërtarisë dhe
3. Sektori i perimekulturës
4. Sektori i pemëtarisë

Sektori i vreshtarisë

Në nivel vendi dihet që plantacione me vreshta janë të ngritur mbi 3,200 ha, me varietete të ndryshme të rrushit. Pjesa dërmuese, ose rreth 70%, e këtyre vreshtave gjenden në Komunën e Rahovecit. Sikurse çdo sektor tjetër bujqësor, që është goditur nga breshëri i datës 14 qershori, edhe sektori i vreshtarisë pëson dëme të konsiderueshme.

Shkalla më e lartë e breshrit ka përfshirë zonën në mes të fshatit Sapniq dhe qytetit të Rahovecit, ku dëmet janë në masën prej 100%. Po ashtu edhe pjesën e Bërnjakës deri në Brestoc ku shkalla e dëmit është rreth 80%.

Komisioni i formuar nga kryetari Smajl Latifi, në bashkëpunim edhe me anëtarin e emëruar nga DVV, kanë dalë në terren dhe kanë përcaktuar saktë sipërfaqen që është prekur nga breshëri, më pastaj nga kadastro i vreshtave janë nxjerr dhe përpunuar të dhënat e sakta të dëmeve të shkaktuara.

Janë bërë dy kategorizime të dëmeve në sektorin e vreshtarisë:

- Dëmet e shkaktuara në rrushin e tryezës dhe
- Dëmet e shkaktuara në rrushin e verës.

Tabela: 1 Rrushi i tryezës

Nr.	Lloji i rrushit	Sipërfaqe e dëmtuar në ha	Sasia në Kg	Çmimi për Kg	Vlera në €
1	Rrush i Tryezës 100%	24.35	89,600	0.50 €	194,800.00 €
2	Rrush i Tryezës 60%	47.62	457,152	0.50 €	228,576.00 €
3	Rrush i Tryezës 40%	113.68	727,552	0.50 €	363,776.00 €
Total		185.65	1,574,304		787,152.00 €

Analiza e vlerësimit të dëmit për kulturën e rrushit konsiston në vlerësimin e sipërfaqes e cila është dëmtuar nga breshëri dhe reshjet e mëdha të shiut. Pas vlerësimit të sipërfaqes komisioni ka vlerësuar sasinë e mundshme që do mund të prodhonte me rrush dhe në fund është caktuar edhe çmimi i tregut për atë varietet. Konform këtyre të dhënavë komisioni ka vlerësuar se janë rreth 1.5 milion kg rrush i

tryezës që është dëmtuar. Kur për këtë sasi të rrushit të dëmtuar shumëzohet me çmimin njësi prej 0.5 €/kg, atëherë vijmë tek analiza se dëmet financiare për rrushin e tryezës kapin vlerën prej 787,152 €.

Tabela: 2 Rrushi i verës

Nr.	Lloji i rrushit	Sipërfaqe e dëmtuar në ha	Sasia në Kg	Çmimi për Kg	Vlera në €
1	Rrush për Verë 100%	42.32	592,480	0.27 €	159,969.60 €
2	Rrush për Verë 60%	52.9	444,360	0.27 €	119,977.20 €
3	Rrush për Verë 40%	138.71	776,776	0.27 €	209,729.52 €
Total		233.93	1,813,616		489,676.32 €

Analogja e njëjtë e analizës edhe te rrushi për verë, ka rezultuar në vlerësimin e komisionit se janë dëmtuar rreth 1.8 milion kg rrush i verës, e që në vlerë financiarë dëmi konsiston në shumën prej afér gjysmë milion euro.

Në të dy grupet vlera e dëmeve arrin: **1,276,828.32€**

Sektori i lavërtarisë

Në sektorin e lavërtarisë ndër dëmet më të mëdha janë krijuar te dy kulturat kryesore, siç janë: Gruri dhe Misri.

Sa i përket grurit duhet të themi, se edhe pak ditë na ndajnë kur pritet të fillojë periudha e korrjesirjeve, e pikërisht në këtë kohë fermerët tanë e pësuan nga fatkeqësitë natyrore.

Llogaritet që këtë vit me këto dy kultura lavërtarë, sipërfaqe të mbjella janë: Grurë 1,600 ha dhe Misër 1,245 ha.

Tani nga këto sipërfaqe të dëmtuara nga breshëri dhe vërshimet kemi 184.13 ha me grurë dhe 212.38 ha me misër.

Tabela nr. 3 Kultura lavërtare

Nr.	Kultura	Sipërfaqe e dëmtuar	Sipërfaqe në % sipas kulturës	Sasia në kg	Vlera në €
1	Gruri	184.13	46.44	533,275	95,989.50 €
2	Misër	212.38	53.56	629,280	151,027.20 €
TOTAL		396.51	100.00	1,162,555	247,016.70 €

Për Grurin komisioni ka vlerësuar se janë dëmtuar rreth 184 ha ose shprehur në sasi në vlerë prej 533,275 kg. Për grurin dëmi kap vlerë financiare afér 100,000€, kurse për misrin janë dëmtuar 212.38 ha ose 629,280 kg, e që në vlerë financiare është: 151,027 €.

Për të dyja bashkë, në sektorin e lavërtarisë janë dëmtuar afër 400 ha dhe se shuma totale e dëmtuar, sipas komisionit kap vlerën prej 247,016 €.

Sektori i Perimekulturës

Vet fakti se Rahoveci njihet edhe si kryeqyteti i bujqësisë kjo dëshmohet edhe nga sipërfaqet e mëdha te mbjella me kultura perimtare.

Llogaritet që me perime janë të mbjellura rreth **1,900 ha**, nga këto pjesën më të madhe e dominojnë sipërfaqet me specia të llojeve të ndryshme dhe duke vazhduar me patate, shalqi, kunguj, qepë etj.

Ky sektor është ndër më të goditurit nga breshri dhe vërshimet që ndodhën në gjysmën e qershorit te këtij viti.

Nga të dhënat e grumbulluara të anëtarëve të komisionit llogaritet se nga breshëri dhe vërshimet janë përfshirë **594.82 ha**, ku dominon kultura e specit me 258.64 ha, e duke vazhduar me kunguj, shalqi, qepë, patate etj.

Tabela nr. 4 Perimekultura

Nr.	Kultura	Sipërfaqe e dëmtuar në Ha	Sipërfaqe në % sipas kulturës	Sasia në kg	Vlera në €
1	Specia	258.74	43.32	4,931,513	1,233,898.13 €
2	Shalqi	58.89	9.86	3,391,980	678,396.00 €
3	Patate	32.13	5.38	514,480	128,620.00 €
4	Domate	7.20	1.20	381,960	152,784.00 €
5	Qepë	54.45	9.12	1,142,920	342,876.00 €
6	Lakra	6.65	1.11	360,220	72,044.00 €
7	Hudhër	7.17	1.20	28,120	56,240.00 €
10	Lulelakër	3.81	0.64	57,725	17,317.50 €
11	Kunguj	104.56	17.51	3,615,480	361,548.00 €
12	Pjepër	18.80	3.15	653,800	196,140.00 €
13	Tranguj	2.13	0.36	30,120	10,542.00 €
14	Tërshërë	5.00	0.84	10,000	2,500.00 €
15	Livadhe	11.10	1.86	44,400	4,440.00 €
16	Karota	2.10	0.35	10,500	10,500.00 €
17	Jonxhë	19.60	3.28	73,080	14,616.00 €
18	Poulonia	5.00	0.84	10,000	2,500.00 €
TOTAL		597.32	100.00		3,284,961.63 €

Sqarim:

Ne këtë tabelë janë paraqitur sipërfaqet e dëmtuar si dhe përqindjen e produkteve në kuadër të tabelës. Kolona "sasia në KG" është kalkuluar në atë mënyrë duke marr për bazë vlerën referente të prodhimit për ha për secilën kulturë, si në rastin konkret për specat: 30,000 kg. Për të përllogaritur vlerën është marr për bazë çmimi mesatar nga viti i kaluar (jemi bazuar në çmimin e qendrave grumbulluese që në vitin 2017 ka qenë 0.25€)

Sektori i pemëtarisë

Tabela nr. 5 Pemëtaria

Nr.	Lloji i kulturës pemëtare	Sipërfaqe e dëmtuar në ha	Sasia në Kg	Çmimi për Kg	Vlera në €
1	Kumbull	6.76	101,400	0.25 €	25,350.00 €
2	Dardhë	0.51	5,000	0.30 €	1,500.00 €
3	Mqedër	0.53	7,000	1.50 €	2,800.00 €
4	Mollë	1.51	10,000	0.30 €	3,000.00 €
TOTAL		10.83			27,580.00 €

Tabela përbledhëse për të gjithë sektorët

Sqarim: Në tabelën e mëposhtme janë kategorizuar dëmet e përgjithshme në perimekulturë, lavërtari, rrushin e tryezës, rrushin e verës dhe pemëtari.

Tabela nr. 6 Tabela e përgjithshme

Nr.	Kultura	Sipërfaqe e dëmtuar	Sasia në kg	Vlera në €
1	Perimekulturë	597.32	15,246,298	3,284,961.63 €
2	Lavërtari	396.51	1,162,555	247,016.70 €
3	Vreshtari	419.58	3,387,920	1,276,82800 €
5	Pemëtari	9.31	123,400	27,580.00 €
TOTAL		1,424.24		4,836,386.65 €

PËRFUNDIM

Raporti është përgatitur me kujdes, falë një punë të mundimshme e cila i ka marrë kohë komisionit për vlerësimin e dëmeve. Komisioni ka dalë në terren ku ka parë, analizuar dhe ka bërë vlerësimin. Natyrisht, se ka pasur edhe vërejtje ndaj komisionit nga palët e dëmtuara për mënyrën, metodën dhe kriteret që ka përdorur komisioni për vlerësim.

DBPZHR ka grumbulluar fotografitë dhe videot si dëshmi që i ruan për të faktuar dëmet e mëdha.

Shkalla e gabimit në gjithë këtë proces është 5%.


Raporti i Komisionit për vlerësimin e dëmeve në bujqësi përmban edhe listën e bujqve të dëmtuar, emrat dhe mbiemrat e tyre, sipërfaqet e dëmtuara, sasinë e përllogaritur në kg. si dhe vlerën financiare të dëmit.

Komisioni vlerësues:

1. Nysret Shala,




2. Jeton Kryeziu,



3. Ilvi Durguti,



4. Selami Mashuku,



5. Arben Sokoli,

